



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

---

Nr. 133 Prot

Tiranë, më 29.08, 2011

**VENDIM Nr. 173, dt. 29.08.2011**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 29.08.2011, mbasi shqyrtoi "Raportin përfundimtar mbi sondazhet arkeologjike përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës të kryer në sheshin e ndërtimit në pronë të **Familjes Fatmir Guza në adresën Lagjja Nr. 6, Rruga "Hajdar Shameti", zona arkeologjike "B", Durrës (Subjekti "IKONA KO" sh.p.k)**,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë raportin përfundimtar të sondazhit arkeologjik, të paraqitur nga ASHA dhe DRKK Durrës për sheshin e ndërtimit të subjektit "**IKONA KO**" sh.p.k, Lagjja Nr. 6, Rruga "Hajdar Shameti", Durrës.
- II. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës të ndjekë procesin e arkëtimit të masës administrative prej 2 (dy) milionë lekë për ndërhyrje të paautorizuar në sheshin e ndërtimit në kundërshtim me kontratën dypalëshe të nënshkruar nga ASHA dhe subjekti "**IKONA KO**" sh.p.k.për ndjekjen e këtyre procedurave.



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
e-mail: [sekretaria.teknike@asha.gov.al](mailto:sekretaria.teknike@asha.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

---

- III. Të pezullohet për një periudhë 3 vjeçare shqyrtimi në KKA i kërkesave për ndërtime në zona arkeologjike "B" në të gjithë territorin e vendit, apo në zona të tjera, ku sipas ligjit kërkohet miratimi i KKA nga subjekti "IKONA KO" sh.p.k. dhe drejtuesi teknik, bazuar në VKM Nr. Nr.237, datë 23.3.2011, "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e zonës arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit".
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E  
SHERBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
e-mail: [sekretaria.teknike@asha.gov.al](mailto:sekretaria.teknike@asha.gov.al)